



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN "TIRANË"**

**VENDIM**

**Nr. 5 datë 07.12. 2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS - SHPIMI, KINOSTUDIO, TIRANË, SUBJEKTI  
"MELISA" SHPK**

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; ligjit 111/2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar" neni 8 pika 1, Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

**V E N D O S I :**

Miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi për subjektin "Melisa" shpk nga shpuesi profesionist Fatos Kopaci, Kinostudio bashkia Tiranë .

1. Koordinatat e vendodhjes së pusit dhe parametrat teknikë :

X=44 034 21      Y=45 797 49      Z=158 m

- a. Thellësia e parashikuar    150 m
- b. Kapaciteti i parashikuar     $Q= 0.7 \text{ l/s}$
- c. Diametri i shpimit          250 mm

2. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij Vendimi

3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN**

**SEKRETAR**

Shpëtim MEDIU

**KRYETAR**

Suzana JAHOLLAR

